



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,  
Kulturë, Rini e Sport  
Mbledhja nr. 40  
Prishtinë, më 18.02. 2010 në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës  
Salla nr. N- 225

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

**Në mbledhje morën pjesë:** Drita Kadriu, Arsim Rexhepi, Heset Cakolli dhe Enis Kervan  
**Munguan:** Donika Kadaj -Bujupi, Memli Krasniqi Mark Krasniqi dhe Dragan Dimiq.

**Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë:** Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

**Në mbledhje prezantuan:** përfaqësuesi i OSBE - së, i NDI - së, përfaqësuesi nga Presidenca dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit si dhe praktikantë të caktuar për Komisionin.

**Mbledhjen e udhëhoqi:** Drita Kadriu zv. kryesuese e parë e Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

**Rend dite**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 26 janar 2010,
3. Diskutim rreth vizitave te komisionit ne Institucionet e kulturës
4. Të ndryshme

Kryesuesja , konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

1. Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 26.01.2010**

**Kryesuesja** konstatoi se pasi shumica e anëtarëve të Komisionit mungojnë miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 26.01.2010 shtyhet për mbledhjen e ardhshme..

## **3. Diskutim rreth vizitave te komisionit ne Institucionet e kulturës**

**Kryesuesja** tha se në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë që i ka të përcaktuara me Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe në pajtim me planin e punës së Komisionit janë paraparë vizita me karakter pune në Institucionet e vendit me qëllim të marrjes së informacioneve më të sakta lidhur me çështjet aktuale në fushë veprimtarinë e Komisionit.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që të vizitohen Institucionet e kulturës.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

### **PËRFUNDIM**

Të hënën më datë 22.02.2010 në orën 10,00 anëtarët e Komisionit të bëjnë vizitë pune në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Të njëjtën ditë në orën 11,00 të vizitohet Teatri Kombëtar me qëllim të njohjes së përafërt me çështjet aktuale në këtë lëmi.

## **4. Të ndryshme**

Mbledhja e ardhshme e Komisionit u caktua të mbahet të martën më 23. 02.2010 në orën 11,00. ku do të debatohet rreth vizitës së Komisionit në Institucionet e kulturës.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 11: 30

### **Përgatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

Kryesuesja e Komisionit,

---

Drita Kadriu